

UNIVERSITETI I MITROVICËS

“ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Mitrovicë

2021

UNIVERSITETI I MITROVICËS

“ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

ARSIMI NË KOSOVË NDËRMJET DY LUFTËRAVE

BOTËRORE 1918-1941 (deri te klasa V)

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Sabit Syla

Kandidatja:

Egëzona Çollakaj

Mitrovicë

2021

UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”

FACULTY OF EDUCATION



BACHELOR THESIS

**EDUCATION IN KOSOVO BETWEEN THE TWO
WORLD WARS 1918-1941 (up to grade V)**

Supervisor:

Prof. Asoc. Dr. Sabit Syla

Candidate:

Egëzona Çollakaj

Mitrovica

2021

UNIVERSITETI I MITROVICËS

“ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: Histori e arsimit kombëtar

Titulli i punimit: Arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore 1918-1941 (deri te klasa V)

Emri dhe mbiemri: Egëzona Çollakaj

Statusi i studentit: E rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri) 1606011065

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimeve: Fillor

Mentori i punimit: Prof. Asoc. Dr. Sabit Syla

Aprovuar prej komisionit:

1. Emri Mbiemri, Titulli/_____, mentor
2. Emri Mbiemri, Titulli/_____, anëtar
3. Emri Mbiemri, Titulli/_____, anëtar

Data e aprovimit: _____

Deklarata e autorësisë

Unë, Egëzona Çollakaj, me përgjegjësi deklaroj se këtë punim e kam punuar unë dhe si i tillë nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni apo komisioni tjetër. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara, duke u bazuar sipas standardeve të pranuara. Andaj, ky punim është rezultat i njohurive, bashkëpunimit dhe hulumtimeve që kam bërë për ta realizuar sa më mirë.

Egëzona Çollakaj

Emri, mbiemri, nënshkrimi

FALËNDERIM

Për shkak të kontributit të madh të njerëzve qëllimshëm përreth meje, unë do t'i përmend disa:

Afërmendsh, jo vetëm për ndihmën në këtë punim, falënderoj pafundësisht profesorin Sabit Syla. Pastaj, falënderoj të gjithë kolegët e koleget që më ndihmuan për realizimin e këtij punimi dhe anëtarët e komisionit. Në fund, por me rëndësi të madhe, falënderoj anëtarët e familjes, të cilët më qëndruan afër edhe kur vetja largohet nga unë.

Faleminderit!

PËRMBAJTJA

Deklarata e autorësisë	5
FALËNDERIM.....	6
PËRMBAJTJA	7
Abstrakti	9
Abstract.....	10
PARATHËNIE	11
HYRJE	12
Zhvillimi i arsimit fillor në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore	14
1.1. Zhvillimi i shkollave fillore 1918-1929 (Vështrim i përgjithshëm).....	14
1.1. Zhvillimi i arsimit sipas qarqeve.....	17
1.2.1 Qarku i Zveçanit	17
1.2.2. Qarku i Dukagjinit	19
1.2.3. Qarku i Kosovës (rrethi i Gjilanit)	20
1.2.4. Qarku i Prizrenit (rrethi i Sharrit dhe rrethi i Gorës)	21
1.3. Përmbledhje.....	23
KAPITULLI II	24
Zhvillimi i arsimit fillor në Kosovë 1929-1941	24
2.1. Vështrim përgjithshëm.....	24
2.2. Zhvillimi i arsimit sipas qarqeve.....	25
2.2.1. Qarku i Mitrovicës	25
2.2.1. Qarku i Pejës	26
2.2.2. Qarku i Gjakovës	27
2.2.3. Qarku i Graçanicës	27
2.2.4. Qarku i Gjilanit	28
2.2.5. Rrethi i Drenicës	30
2.2.6. Rrethi i Llapit	30
2.3. Përmbledhje.....	31

3. Vështrim empirik	33
Përmbajtja:	33
Diskutime dhe konkluzione	35
Rekomandime	36
LITERATURA	37

Abstrakti

Në këtë punim për bachelor do të përpiqem që të sjell një reflektim mbi arsimin fillor në Kosovë brenda viteve 1918-1941 Sigurisht, vetë përkufizimi i titullit të temës, në njëfarë mënyre, përcakton edhe rrugën e punimit. Prandaj, vështrimi historik mbi funksionin arsimit në Kosovë do të jetë pikënisje mbarështuese e studimit.

Në këtë punim paraqitet në aspektin e përgjithshëm arsimit fillor dhe zhvillimi gjatë periudhës 1918-1941. Fakte historike e rrethana politike për dimensionin e zhvillimit të arsimit në mes dy luftërave botërore në Kosovë. Vështirësitë e diskriminimi arsimor e kulturor që ka përshkuar shqiptarët në këtë etapë historike.

Po ashtu, në këtë punim, është tentuar jo veç të sillen faktet në dritën e kohës, por edhe të ndahen proceset arsimore sipas qarqeve. Me qëllim që të japim një pasqyrë sa më reale, për arsimin në mes dy luftërave, ky punim trajton në kapituj të veçante arsimin fillor në dy periudha edhe për shkak rrethanave politike. Saktësisht mes vitit 1918-1929 dhe 1929-1941. Kurse në fund paraqitet edhe një vështrim përshkrues nga libri i Historisë 5, libër që përdoret në tërë arsimin fillor në Kosovë.

Shprehje kyçe

Arsimi; Shkolla; Kosova; Lufta.

Abstract

In this bachelor thesis I will try to bring a reflection on primary education in Kosovo within the years 1918-1944. Of course, the very definition of the title of the topic, in a way, determines the way of working. Therefore, the historical overview of the education function in Kosovo will be a breeding ground for the study.

This paper presents in general terms primary education and development during the period 1918-1941. Historical facts and political circumstances for the dimension of education development between the two world wars in Kosovo. The difficulties and educational and cultural discrimination that has pervaded Albanians in this historical stage.

Also, in this paper, it is attempted not only to bring the facts in the light of time, but also to divide the educational processes according to the regions. In order to give a more realistic picture of education between the two wars, this paper deals in separate chapters with primary education in two periods also due to political circumstances. Exactly between 1918-1929 and 1929-1941. Finally, there is a descriptive look from the book of History 5, a book that is used in all primary education in Kosovo.

Key expressions

Education; School; Kosovo; War.

PARATHËNIE

Hartimit të kësaj teme iu kam qasur me shumë kujdes dhe me shumë modesti, sepse objekti i studimit është shumë specifik si në kohë, ashtu edhe në hapësirë. Arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore karakterizohet me shumë vështirësi dhe me një gjendje jo të mirë të shoqërisë shqiptare në atë periudhë. Gjithsesi, pas sigurimit të literaturës bazë e, sidomos, pas shqyrtimit të saj, u nxita edhe me më shumë vullnet që t'i futem hulumtimit për këtë temë. Në shumë rrafshe është teme sa e gjerë, aq edhe e thellë, prandaj përpjekja për të sjell diçka në dritë bëhet bosht i hulumtimit. Tema është e ndarë në kapituj dhe secili kapitull ofron fakte të kohës për nivelin e arsimit fillor. Ndonëse gjendja e shqiptarëve të Kosovë atëbotë ishte në nivelin më të ulët të respektimit të drejtave të tyre, prapë përpjekjet për arsimim nuk mungonin. Duke e trajtuar këtë çështje tejet komplekse, ne mëtojmë të vëmë në spikame dritëhijet e gjendjes shqiptare në raport me arsimin në Kosovë. Arsimi në atë periudhë e, veçanërisht, në Kosovë kishte vështirësitë e veta, sepse Kosova dilte nga një epokë tjetër, ku rrjeti i shkollave ishte i varfër e organizimi tejet i dobët, për shkak të politikës së ndjekur nga organet e larta qeverisëse të Jugosllavisë. Për ta përforcuar këtë, mjafton të shikohet se shkollat e para në Kosovë, në këtë periudhë, janë hapur në mjedise me shumicë sllave, kurse popullata shqiptare kishte një përqindje të madhe të analfabetizmit. Duke pasur parasysh mënyrën e shtruarjes së problemit, interpretimit të fakteve, të argumenteve etj, mendoj se mbarështimi i këtij studimi është ofruar në mënyrë të përgjithshme. Andaj, çështja për studim më të thellë e më të pasur është sfidë tjetër në një nivel tjetër akademik.

HYRJE

Në vitin 1912 Kosova u nda nga Turqia, por u aneksua nga Serbia dhe Mali i zi. Serbia dhe Mali i Zi ndërmorën masa represiale ndaj popullit shqiptar. Kufiri i Malit të Zi dhe Serbisë ishte lumi Dri në Dukagjin. Në vitin 1913 në Pejë dhe Prishtinë ishin hapur gjimnazet në gjuhën serbe. Në Pejë gjimnazi ishte hapur me dekretin e Karl Nikollës të Malit të Zi, ndërsa në Prishtinë me dekretin e Kral Aleksandrit. Këto gjimnaze vepruan për një periudhë të shkurtër, meqë në periudhën e viteve 1915-1918 Kosova ishte nën sundimin e Austro- Hungarisë, e cila nuk lejoi veprimtarinë e këtyre shkollave.¹

Në këtë punim do ta trajtojmë një periudhë shumë delikate të historisë së arsimit në Kosovë. Do të trajtojmë periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, te viteve 1918-1941. Një periudhë e tillë ishte shumë e vështirë për shqiptarët atëbotë, sepse dilnim nga një rrethanë e kontekst tjetër politik, ndërsa infrastruktura e kuadri ishin mungesë shumë e madhe për shqiptarët në Kosovë. Ky punim do të sjell fakte e rrethana reale të asaj kohë dhe peripecitë e shqiptarëve për përpjekjen në arsim. Sikundër, kjo periudhë u karakterizua edhe me ndryshime politike, ku domosdoshmërisht ndikuan shumë edhe në qasjen e mundësinë për arsimim në Kosovë.

Pavarësia e Shqipërisë ishte e mirëseardhur dhe një pjesë të saj, pas shumë mundimeve, arriti ta mëvetësoj nga pushtuesit e pretendimet e tjera. Mirëpo, kjo gjë nuk është se ndodhi ashtu siç e idealizonin shqiptarët, sepse një pjesë e madhe e shqiptarëve mbetën jashtë kufijve të sotëm të Shqipërisë. Në këtë gjë, shqiptarët nga Kosova pësuan më së shumti, sepse nën Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene u gjet para shumë sfidave. Këto sfida e diskriminime preken edhe sferën e arsimit, sepse shqiptarëve nuk u dha mundësia të arsimoheshin në gjuhën shqipe e infrastruktura ishte nën çdo nivel.

Shqiptarët e Kosovës pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore u gjetën nën pushtimin e Mbretërisë së SHKS-së dhe si pasojë mungonte organizimi, orenditë shkollore, tekstet shkollore, kuadri arsimor e mjetet mësimore. Vetë fakti që diskriminimi ndaj shqiptarëve ishte i theksueshëm

¹ Bajram Shatri, Arsimit dhe shkollat e mesme në shekullin XX, (Prishtinë: 2010), 29.

në çdo pore të jetës, tregon shumë për realitetin e asaj kohë. Ndërkohë, gjatë këtij punimi, gjendja e arsimit fillor në Kosovë sillet si fakt duke u bazuar edhe në dy periudha, pra 1918-1929 dhe 1929-1941. Kjo ndarje bazohet edhe në ndarjet që kanë bërë studiuesit e mirëfilltë të kësaj periudhe dhe, pa dyshim, determinohet edhe nga konteksti politik.

Shqiptarëve i ndalohej liria e lëvizjes, i ndalohej lira e shprehjes së mendimit, liria e arsimimit në gjuhë amtare dhe shumë të drejta të tjera që karakterizojnë qenien etnike të secilit komunitet. Andaj, diskriminimi arsimor del jo veç e thënë fjalës, por edhe e vërtetë faktike, ngase në të gjithë territorin e Mbretërisë së SKS-së, legalisht nuk punonte asnjë shkollë në gjuhën shqipe. Përjashtojmë atyre katolike, ku sipas Abdullah Vokrit, ishin nën patronatin e Austro-Hungarisë.

Diskriminimi në këtë periudhë shkonte gjer në skajet e veprimet, sepse nxënësit shqiptarë jo që duhej të shkolloheshin vetëm në gjuhën serbe, por edhe të shkonin një vit në klasën përgatitore për ta mësuar gjuhën serbe. Nxënësit shqiptarë duhej të bënin shumë më shumë punë e mësim vetëm që të arrinin të mbaronin shkollën. Mirëpo këtu nuk ndalej diskriminimi, sepse nxënësve shqiptarë u ndalohej të flisnin shqip në mjedise shkollore dhe shpeshherë padrejtësisht ndëshkoheshin edhe fizikisht gjatë orës mësimore.

Prej të gjithë popujve që kanë jetuar në Jugosllavi gjatë kësaj periudhe, shqiptarët kanë qenë populli më i diskriminuar. Të nënçmuar e jashtë çdo sistemi për realizimin e të drejtave të tyre, Nuk kishin shkolla në gjumë amtare, nuk kishin të drejta elementare për përdorimin e gjuhës shqipe dhe të përjashtuar në çdo sferë tjetër. Kjo periudhë ishte e errët për popullin shqiptar në Kosovë, sepse çdo gjë ishte prapangelje dhe asnjë mundësi për të realizuar të drejtat elementare. Kjo gjendje e mjerueshme futi shqiptarët në një rreth sikur nuk mund të dilnin kurrë, ndërsa shkalla e analfabetizmit ishte shumë e lartë.

KAPITULLI I

Zhvillimi i arsimit fillor në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore

1.1. Zhvillimi i shkollave fillore 1918-1929

(Vështrim i përgjithshëm)

Me organizimin e pushtetit civil në Kosovë filloi zhvillimi i shkollave dhe i arsimit. Bartës kryesor të këtij zhvillimi ishin komunat shkollore, të cilat datojnë që nga viti 1918. Ato kujdeseshin për mbarëvajtjen e punës së shkollave. Çdo komunë shkollore bënte financimin e shkollës. Kjo arrihej përmes taksës e mbitaksës ose kredive të cilat i lejonin bankat. Në buxhetin e shkollës parashihej pajisja e shkollës me inventar shkollor, me mjete mësimore, me biblioteka shkollore, si dhe material harxhuese dhe të ardhurat e personelit mësimor.² Sipas studiuesit Abdulla Vokrri, në secilën komunë vepronte Këshilli i shkollës. Ky këshill luante rol të rëndësishëm për organizimin e procesit mësimor, ndonëse shumica e tyre ishin analfabetë e shpesh paraqiteshin edhe probleme apo mosmarrëveshje.

Shkollat fillore në këtë periudhë ishin katërkatëshe dhe fare pak pesëkatëshe. Derisa procesi mësimor në Kosovë ishte i organizuar vetëm në gjuhën serbe, në Vojvodinë shkollat ekzistonin edhe për “pakica” kombëtare. Nxënësit shqiptarë mësimet i kanë vijuar në “gjuhën shtetërore” serbe, numri i të cilëve ishte shumë i vogël. Kështu, p.sh., sipas një burimi, në vitin 1921, mbi 95 për qind e popullit shqiptar të Kosovës ishte analfabetë.³ Ndërsa, sipas Bajram Shatrit, ndonëse me ligj ishte e precizuar procesi mësimor për pakicat, parape për shqiptarët nuk vlente, sepse mbretëria jugosllave shqiptarët nuk i njihte si popull dhe askush nuk guxonte të fliste për gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Në vitin shkollor 1918/19, duke përjashtuar ish-rrethin e Kaçanikut, në tërë territorin e sotëm të Kosovës, punonin gjithsej 68 shkolla fillore. Kjo është dëshmia më e mirë se asokohe kemi pasur një rrejt shkollor tejet të varfër.⁴ Sa i përket kuadrit profesional, sipas Abdulla Vokrrit,

² Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 25.

³ Grup autorësh, Kosova dikur e sot, (Prishtinë: 1972). 610.

⁴ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 26.

shkollat fillore të kësaj treve kishin kuadrin më të papërgatitur. Në fillim u gjetën vetëm ata që sa kishin mësuar shkrim-leximin. Ky kuadër në përbërje kishte: mësuesit e përhershëm, mësuesit e përkohshëm dhe ushtruesit e detyrë së mësuesit.

Hapja e shkollave në Kosovë nuk është bërë me tempo të njëjtë. Në disa vende të këtij rajoni kemi pasur një tempo më të shpejtuar, e në disa mjedise të tjera më të ngadalësuar. Këtë situatë kësisoji e kanë kushtëzuar rrethanat ekonomike, shoqërore dhe politike të kësaj periudhe. Shkollat e para janë hapur në ato vende të cilat ishin të banuara me popullsi sllave, madje në ato vendbanime me popullate të përzier e shumë rrallë janë hapur në ato vende të etnikumit të pastër shqiptar. Shkolla e kësaj kohë konsiderohej edhe si mjet për kolonizimin e Kosovës me serbë dhe malazezë.⁵ Sipas të njëjtit studiues vlen të theksohet se kishte shumë ndryshime të mëdha mes zonave, sepse kjo varej edhe nga qasja që kishin për shkollën, si dhe vetë nga mësuesit.

Shkollat që u hapën në Kosovë e në viset e e tjera shqiptare u jepnin nxënësve njohuri elementare, si dhe aftësim fillestar vetëm për shkrim e lexim. Deri në gusht të vitit 1926, kur u miratua plani e programi i ri shkollor, në shkolla punohej pa një plan të njësuar arsimor. Gjuha serbokroate zinte vendin qendror në mësim.⁶

Sipas planit dhe programit të vitit 1926, gjuha serbokroate zinte vendin qendror. Për të gjithë klasat e fillores, fondi javor i orëve nga kjo lëndë mësimore ishte 7. Vendin e dytë dhe të tretë për nga rëndësia e ndanin: fillet e ushtrimit real, historia dhe aritmetika. Mësimi i besimit ishte shndërruar në lende të obligueshme mësimore për të gjithë fetë. Këtë lëndë mësimore e jepnin priftërit dhe hoxhallarët, varësisht nga përkatësia fetare. Tërësitë programore nga këto lënde mësimore ishin të e seleksionuar asisoji që përmes tyre të arrihen dy qëllime kryesore. Së pari, të lartësohej populli serb përmes shembujve të ndryshëm të nxjerrë nga letërsia dhe historia, në mënyrë që te nxënësit të zhvillonin vetëdijen kombëtare e patriotike. Ndërsa, qëllimi i dytë ishte që përmes përmbajtjeve të lendeve mësimore, të ndikohet në mënyrë të organizuar për denacionalizmin dhe shkombëtarizimin e elementit josllav. Këta dhe shembujt e tjerë janë dëshmia më e mirë se pos karakterit arsimor, shkollat e këtyre anëve kishin edhe karakter politik.⁷ Madje,

⁵ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 28

⁶ Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar III, (Tiranë: 2007), 489.

⁷ Dr. Maria Jovanovik, Prosvetno politickite prilike, vo vardarska Makedonija 1918-1929, (Skopje: 1983), 96. (cituar nga Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, autor Abdulla Vokrri)

Serbia mori masa për ta bllokuar komunikimin ekonomik, arsimor e kulturor me Shqipërinë. Qeveria serbe mori masa të rrepta për të mbyllur të gjitha rrugët e komunikimit njerëzor, ekonomik e arsimor-kulturor ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës. U ndalua plotësisht futja në Kosovë e gazetave dhe e revistave shqipe. Atij që i gjendej libri shqip në këtë periudhë, si në kohën e sundimit osman, e paguante me kokë. Në të njëjtën kohë autoritetet serbe ndërmorën të gjitha masat, që studentëve kosovarë, të cilët studionin në Shqipëri, Itali, Austri e gjetiu, t'u pengojë sa të ishte e mundur kthimi në Kosovë.⁸

Për t'i përforcuar faktet e sipërthënë, ne po sjellim në mënyrë ilustrative një tabelë të fondit të orëve. Tabela është marrë nga libri *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore*, autor Abdulla Vokri. Ndryshime formale të tabelës nuk ndryshojnë përmbajtësish tabelën orgjinale. Këto të dhëna në tabelë, sipas Abdulla Vokrit, janë të viti 1926.

Nr.	Lëndët mësimore	Klasat				Gjithsej
		I	II	III	IV	
1	Shkenca e besimit	2	2	2	2	8
2	Serbokroatisht	7	7	7	7	28
3	Fillet e ushtrimit real	3	4	-	-	7
4	Gjeografi	-	-	2	2	4
5	Histori e natyrës	-	-	2	3	5
6	Matematike me gjeo	4	4	4	4	16
7	Dituri natyre	-	-	3	3	6
8	Vizatim	1	1	1	1	4
9	Bukurshkrim	1	1	1	1	4

⁸ Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar III, (Tiranë: 2007), 488.

10	Punë dore	2/2	2	2	2	4
11	Këngë	2/2	2/2	2/2	2/2	4
12	Gjimmastikë	2/2	2/2	2/2	2/2	4
	Gjithsej	22	23	26	27	98

(Tabela 1: Fondi i orëve sipas Planit dhe Programit 1926)

1.1. Zhvillimi i arsimit sipas qarqeve

Për zhvillimin e arsimit nëpër qarqe do të ndalemi vetëm në disa pika që përkojnë me qasjen e kësaj teme rreth objektit të studimit. Këto pika përfshijnë përbërjen e këtyre qarqeve, rrjetin shkollor, përfshirjen e nxënësve në shkolla dhe kuadrin mësimor. Qasja do të jetë përshkruese.

1.2.1 Qarku i Zveçanit

Përbërja: Sipas ndarjes territoriale të vitit 1920, Qarku i Zveçanit përfshinte në vete tri rrethe: Mitrovicën, e cila kishte tetë komuna administrative, në të cilën përfshiheshin gjithsej 130 vendbanime, me 16107 banor, kryeshef ishte Karajoçiq; rrethi i Vuçitërnës me kryeshef Z. Mitiq, që përfshinte 9 komuna administrative me 97 vendbanime e me 42405 banorë; rrethi i Drenicës me seli në Llaushë, i cili kishte 7 komuna administrative me 75 vendbanime e me 23821 banorë, me kryeshef S. Mariq. Pra, qarku i Zveçanit kishte 25 komuna, me 302 vendbanime e me 81733 banorë, kryeshef ishte M. Baniq.⁹

Rrjeti shkollor: Në vitin 1918/1919 në këtë qark ishin hapur 16 shkolla fillore, prej të cilave punonin vetëm 10. Ndërkohë në fillim të vitit 1919/1920 Qarku i Zveçanit kishte 13 komuna politike me 15 komuna shkollore ku punonin gjithsej 23 shkolla fillore, prej të cilave 6 ishin në qytete e 16 në fshatra. Kurse në vitin shkollor 1927/1928 Qarku i Zveçanit kishte gjithsej 32

⁹ Dr. Liman Rushiti, Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928), (Prishtinë, 1981), 27.

shkolla fillore. Në këtë vit shkollor nuk kishte ngelë asnjë vend në këtë qark që nuk ishte përfshirë në ndonjërin prej komunave politike shkollore.¹⁰

Përfshirja e nxënësve: Vlen të theksohet se përfshirja e shqiptarëve ishte simbolike për shkak të zhvillimit të mësimin në gjuhën serbe. Po ashtu, edhe përfshirja e femrave ishte shumë e vogël. Më poshtë po paraqesim një tabelë të marrë nga studiuesi Abdulla Vokrri.

Nxënësit sipas gjinisë

v. shkollor	Nr. Paralele	Meshkuj	femra	Gjithsej nxënës
1918/19	28	846	281	1127
1919/20	34	1064	292	1356
1920/21	47	1878	290	2168
1921/22	40	1961	636	2597
1922/23	50	1935	647	2562
1923/24	54	1892	562	2454
1924/25	60	1889	497	2386
1925/26	65	1688	802	2490
1926/27	76	2763	528	3291
1927/28	79	2915	655	3570
1928/29	82	1621	296	2217
1918/1929	615	20452	5786	26238

(Tabela 3)

Kuadri mësimor: Në vitin 1919/20 në këtë qark punonin gjithsej 37 mësimdhënës, prej të cilëve 23 meshkuj dhe 7 femra. Ne mesin e tyre punonin edhe 7 mësues feje. Numri gjatë viteve rritej, por ndërkohë mësues shqiptarë nuk kishte pos atyre të fesë. Në vitin shkollor 1925/26 numri I mësimdhënësve krahasor me vitin e kaluar ishte shtuar për dhjetë. Tani punonin 83, prej tyre 24 mësues. Mësues të paraluftës ishin 11, të ardhur nga Mali I Zi 17 nga Bosnja 7, nga Serbia 32 dhe

¹⁰ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 28.

nga Rusia 4 mësues. Gjithsej mësues besimi në këtë qark ishin 21. Në vitin 1928/29 vërehet një rënie e numrit të mësimeve. Shkaku duhet kërkuara në transferimi nga ky qark, mirëpo kishte edhe asi që ishin në pushim mjekësor.¹¹

1.2.2. Qarku i Dukagjinit

Përbërja: Në vitin 1920 ky qark përfshinte në veti tri rrethe: Atë të Pejës, të Gjakovës dhe të Istogut. Peja ishte qendra kryesore e këtij qarku.¹² Peja kishte 21 komuna administrative, 287 vendbanime, 82.156 banorë dhe udhëheqës ishte Vasileviq. Gjakova kishte 7 komuna administrative, 97 vendbanime, 27800 banorë dhe udhëheqës ishte Mille Markoviq. Istogu kishte 6 komuna me 70 vendbanime, 18 947 banorë dhe udhëheqës ishte Jakov Samarxhixh.

Rrjeti shkollor: Të dhënat statistikore tregojnë se rrjeti i këtyre shkollave në fillimet e tyre ishte shumë i varfër. Për shembull, sipas studiuesit Liman Rushiti, në vitin në 1918 ky qark kishte 10 shkolla në 41 paralel dhe 28 mësime. Po ashtu, sipas të njëjtit studiues, rrjeti shkollor njeh një sukses në vitin 1925/1926 ku ndërtohen 10 godina shkollore në vende të ndryshme. Kurse, viti 1928/1929 ishte mbyllur me gjithsej 34 shkolla, ku tregon se brenda periudhës 1918/1929 është punuar bukur shumë në ndërtimin e shkollave.

Përfshirja e nxënësve: Sipas studiuesit Abdullah Vokri, përfshirja e nxënësve në këtë qark çdo vit është ngritur në mënyrë suksesive. Për shembull në vitin 1919/1920 në këtë qark e vijonin mësimit 2271 nxënës, prej të cilave 484 ishin femra. Ndërsa kishin mbetur pa u përfshirë 6675 nxënës të moshës shkollore, gjë që tregon shumë për rrethanat e kohës, sepse numri më i madh prapë mbetet jashtë shkollave. Kurse viti 1928/1929 krahasor me vitet e tjera ishte i suksesshëm edhe në performancë, edhe në përfshirje të nxënësve në shkolla. Mirëpo, gjithsesi, pjesëmarrja e shqiptarëve prapë ishte e vogël, sepse mësimi zhvillohej në gjuhën serbe.

Kuadri mësues: Vlen të theksohet se edhe në këtë qark mësues shqiptarë nuk kishte. Të gjithë vinin nga Serbia, Mali i Zi e Rusia, kurse numri i tyre rritej varësisht nga vitet në vit. Kjo varej edhe nga përfshirja e nxënësve në shkolla. Në vitin 1920/1921 kishte gjithsej 59 mësues. Numri i tyre rritej dhe në vitin 1928/1929 kishte gjithsej 166 mësime. Pjesa më e madhe e këtyre mësimeve punonin me klasë të kombinuara.

¹¹ Abdulla Vokri, "Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore", (Prishtinë: 1990), 41.

¹² Dr. Ilman Rushiti, Lëvizja kacake në Kosovë (1918-1920), (Prishtinë: 1981), 27.

1.2.3. Qarku i Kosovës (rrethi i Gjilanit)

Meqenëse rrethi i Gjilanit përbënte pjesë më të madhe për nga komunat e banorët, ne do të ndalemi më në detaje te kjo pjesë. Kurse për rrethet te tjera, jo që nuk janë në interes tonin, por edhe ashtu rrjeti shkollor ishte shumë-shumë i varfër, madje ndër më të varfëritë ishte rrethi i Llapit, sepse, sipas studiuësit Abdulla Vokri, në këtë pjesë kolonizimi filloi më vonë.

Përbërja: Në këtë qark bënin pjesë: Rrethi i Gjilanit, Nerodimës, Graçanicës dhe Llapit. Aso Kohe kishte 25 komuna, 506 vendbanime dhe 251387 banorë. Në vitin 1920 rrethi i Gjilanit kishte 17 komuna me 208 vendbanime e 95 000 banorë. Qendra kryesore ishte rrethi i Gjilanit, ndërkaq, perfekt ishte Lubomir Jovanoviq. Në rrethin Nedorimës me qendër Ferizajin përfshiheshin 10 komuna me 73 vendbanime dhe 32845 banorë. Në rrethin e Graçanicës përfshiheshin 15 komuna, 136 vendbanime dhe 78248 banorë. Kurse rrethi i Llapit përbehej prej 12 komunave, 88 vendbanime dhe 27084 banorë.¹³

Rrjeti shkollor: Në formë tabelare do ta sjellim rrjetin shkollor nëpër vite në rrethin e Gjilanit.

Nr.	Viti shkollor	Nr. I shkollave	Nr. i paraleleve
1	1918/19	7	24
2	1919/20	12	28
3	1920/21	16	30
4	1921/22	20	37
5	1922/23	24	38
6	1923/24	25	38
7	1924/25	25	40
8	1925/26	26	40
9	1926/27	26	39
10	1927/28	27	43
11	1928/29	31	60

(Tabela 4)¹⁴

¹³ Dr. Ilman Rushiti, Lëvizja kacake në Kosovë (1918-1920), (Prishtinë: 1981), 27.

¹⁴ Abdulla Vokri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 55.

Përfshirja e nxënësve: Edhe këtë pjesë do ta sjellim në formë tabelare, për ta parë ecurinë e rritjes së numrit të nxënësve një pjesëmarrje nëpër shkolla.

Viti shkollor	Numri i nxënësve		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej

1918/19	822	214	1096
1919/20	1080	320	1400
1920/21	1026	455	1481
1921/22	1209	650	1859
1922/23	1306	620	1926
1923/24	1395	629	2024
1924/25	1535	529	2124
1925/26	1552	406	1958
1926/27	1550	600	2150
1927/28	1640	853	2493
1928/29			

(Tabela 5)¹⁵

Kuadri mësimor: Njëri ndër problemet më të mëdha në këtë rreth, po edhe në të gjithë qarkun, ishte padyshim mungesa e kuadrit mësimor. Në vitin shkollor 1918/1919 në rrethin e Gjilanit punonin 26 mësime dhënë, 7 prej tyre femra. Këta punonin në kushte të vështira, sepse mungesa e infrastrukturës shkollore ishte problemi kryesor i këtij rrethi në veçanti, por i të gjithë qarkut në përgjithësi. Ndërkohë gjatë viteve numri i kuadrit mësimor rritej krahas edhe rritjes së shkollave e numrit të nxënësve.

1.2.4. Qarku i Prizrenit (rrethi i Sharrit dhe rrethi i Gorës)

Në këtë qark do të ndalim në detaje për pikat e vendosura si objekt paraqitjeje vetëm te rrethi i Sharrit, meqenëse për nga përbirja ishte më i madh dhe meqenëse vështirësitë

¹⁵ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 55.

infrastrukturore, pjesëmarrja e kuadri arsimor në rrethin tjetër ishin në kushte të renda. Si përbërje do të flasim për të dy rrethet, ku do të paraqesim shtrirjen e tyre dhe numrin e banorëve, ndërkaq në pikat të tjera vetëm për rrethin e Sharrit.

Përbërja: Rrethi i Sharrit në vitin 1920 kishte 16 komuna politike, 57 vendbanime dhe 22717 banorë. Qyteti i Prizrenit asokohe ishte komunë vete dhe kishte 16370 banorë. Rrethi i Gorës kishte 16 komuna politike, 52 vendbanime dhe 14.677 banorë.¹⁶

Rrjeti shkollor: Në vitin shkollor 1918/1919 në këtë rreth ekzistonin 20 shkolla fillore. Prej tyre punonin 11, ndërsa 8 nuk punonin fare, sepse ende nuk ishin siguruar lokalet shkollore. Krahasuar me gjendjen fillestare nga e kaluara, në këtë rreth ishte bërë punë e mirë, s' duhet harruar se në vitin 1918 vetëm 6.87% dinin shkrim e lexim. Në vitin shkollor 1924/25 në këtë rreth punonin gjithsej 26 shkolla, prej tyre të përhershme 14, të përkohshme 9 dhe në pronësi të shtetit ishin tri ndërtesa shkollore. Duke filluar prej këtij viti shkollor e gjer në atë 1928/29 vërehet një stagnim në zgjerimin e rrjetit shkollor, sepse numri i shkollave ishte pothuaj i njëjtë.¹⁷

Përfshirja e nxënësve: Në fillim të vitit shkollor 1918/19 përfshirja e nxënësve në shkollat e këtij rrethi ishte bërë vetëm pjesërisht, sepse në një anë mungonte lokali shkollor, ndërsa në anën tjetër edhe kuadri arsimor. Në këtë vit shkollor mësimet i vijonin 1355 nxënës, prej të cilëve 937 meshkuj dhe 418 femra, të shpërndarë në 28 paralele, prej tyre 16 paralele të meshkujve dhe 12 të përziera. Në vitin 1928/1929 vërehet një shtim i theksuar i numrit të paraleleve të nxënësve. Prej gjithsej 1880 nxënësve sa kishin shkollat e këtij rrethi, 1042 ishin shqiptarë, ndërsa 714 serbë, kroatë dhe sllovenë.¹⁸

Kuadri arsimor: Në vitin shkollor 1918/1919 në shkollat e këtij rrethi punonin gjithsej 30 mësimdhënës, prej tyre 7 femra. Hapja e shkollave të reja impononte nevojën e angazhimit të ekuadrit të ri arsimor, Nëse kihet parasysh shtimi i paraleleve të nxënësve, atëherë brenda çdo viti kërkohet që të emërohen se paku nga 5 mësimdhënës të rinj. Ndërkohë në vitin 1928/29 punonin 69 mësimdhënës. Me shkollë normale ishin 26 veta, me atë të bogosllavisë 19 veta, me gjimnaz

¹⁶ Dr. Liman Rushiti, Lëvizja kacake në Kosovë (1918-1920), (Prishtinë: 1981), 27.

¹⁷ Abdulla Vokri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 80. (vepër e cituar).

¹⁸ Abdulla Vokri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 80.

një, me shkolla të tjera 28 mësues. Sipas nacionaliteteve kishte 44 serbë, 21 turq, 3 shqiptarë dhe një kroat.¹⁹

1.3. Përmbledhje

Nga statistikat e shfletuara, nga mendimet e studiuesve dhe nga faktet historike del se shqiptarët në këtë periudhë kishin qenë në një gjendje shumë të vështirë arsimore. Të diskriminuar e të anashvendosur në çdo mundësi, sepse pushtetit i asokohe substancën shqiptare mendohej ta zhbënte përmes arsimit. Mësimi zhvillohej në gjuhën serbe, pjesëmarrja e shqiptarëve nuk ishte e kënaqshme, infrastruktura shkollore ishte në gjendje të mjerueshme dhe kuadri mësimor mungonte. Prania e vajzave në shkolla ishte e vogël në nivel të përgjithshëm dhe shumë e vogël në veçanti për shqiptarë. Kjo prapambetje arsimore ishte e trashëguar edhe më herët, ngase shqiptarëve u mohua arsimi në gjuhën shqipe dhe veçanërisht shqiptarët e Kosovës u gjeten në një pozitë shumë të vështirë. Nxënësit shqiptarë nuk ishin të barabartë me nxënësit serbë. Nuk e njihnin gjuhën serbokroate. Në çdo orë të mësimit shqiptarët përbuzeshin, përqeshësin, fyheshin si nga mësimdhënësit, ashtu edhe nga mocanikët e tyre joshqiptarë.²⁰ Megjithëkëtë, përpjekja për asimilim e errësim mendor nuk është se i doli sipas planeve pushtuesve, sepse shqiptari i Kosovës tejkaloi barrierat e shumta dhe arriti ta ruajë gjuhën, kulturën e traditën shqiptare në cilëndo rrethanë të gjendur.

¹⁹ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 80.

²⁰ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 303.

KAPITULLI II

Zhvillimi i arsimit fillor në Kosovë (1929-1941)

2.1. Vështrim përgjithshëm

Prej vitit 1919/1941, arsimi shqip prapë kthehet në një gjendje të mjeruar, prapë shqipja ngulfatet nga pushteti i atëhershëm jugosllav, prapë nuk lejohet mësimi në gjuhën shqipe as në shkollën fillore katërkatëshe. Shkollat dhe arsimi shqip, siç nuk u lejua të veprojnë në kohën e Perandorisë Osmane, edhe në këto vise u lejua shkolla në gjuhën serbe sipas planeve dhe programeve mësimore të Serbisë, por që gjuha turke ishte e obligueshme, ashtu nuk u lejua as në shtetin jugosllav në periudhën 1918-1941.²¹ Sipas ligjit të (Mbretërisë së Jugosllavisë) për shkollat popullore të vitit 1929, mes të tjerash, thuhet se në vendet e tjera, ku në masën më të madhe jetojnë qytetarët e gjuhës tjetër, hapet paralele të veçantë të shkollës fillore për fëmijët e tyre. Me këtë parashihej që një paralele nuk mund të kishte më pak se 30 nxënës.²² Mirëpo kjo nuk vlente për shqiptarët, sepse siç e kemi thënë më lart, ky pushtues nuk e njihte as si pakicë.

Gjatë viteve 1929-1941, kur u formua Mbretëria Jugosllave dhe u vendos diktatura monarko-fashiste, u shtuan përpjekjet e serbomëdhenjve për përfshirjen e rinisë shkollore në “Jugosllavinë integrale”. Në vitin 1934-35 me dekret të posaçëm filloi emërtimi i shkollave në Kosovë me emrat e personaliteteve të ndryshme serbe, si “Knjaz Llazari”, “Sveti Sava”, “Stefan Deçanski” e të tjerë, që kishin si synim të arrihej sërëbizimi i plotë i trevës.²³

Në këtë periudhë, arsimi në gjuhën serbe, sipas Abdullah Vokrrit, organizohej sipas komunave shkollore. Secila komunë shkollore kishte këshillin e vet, i cili kujdesej për funksionimin e tyre. Në këtë periudhë me shkollat qeverisnin drejtorët e shkollave. Mbikëqyrja ndaj shkollave dhe ndaj punës së mësimdhënësve e bënin inspektorët e shkollave të qarkut, inspektorët e shkollave dhe të dërguarit e Ministrisë së Arsimit. Inspektorët e shkollave të rrethit

²¹ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në shekullin XX në Kosovë*, (Prishtinë: 2006), 42.

²² Bajram Shatri, *Arsimi fillor në shekullin XX në Kosovë*, 42.

²³ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar III*, (Tiranë: 2007), 491.

në Kosovë kanë qenë nga radha e mësuesve të dalluar. Ata në të njëjtën kohë ishin edhe referentë të arsimit.²⁴

Në vitin shkollor 1939/1940, në edukimin dhe arsimimin fillor të Kosovës vetëm në gjuhën serbe ishin të përfshirë rreth 30 për qind të fëmijëve shqiptarë të moshës shkollore dhe 70 për qind e tyre kishin ngelur jashtë shkollës. Në këtë vit shkollor në arsimin fillor katërkatësh në Kosovë kishte 250 shkolla me 654 paralele, të cilat kishin 37505 nxënës. Me këta nxënës punonin 728 mësues (të gjithë joshqiptarë), prej të cilëve femra ishin 222 sosh.²⁵

Në periudhën e Mbretërisë Jugosllave, në Kosovë ka punuar një numër i madh shkollash fillore. Ato hapeshin, kryesisht në ato mjedise që ishin të banuara me popullsi sllave. Sipas thirrjes ato ishin shkolla popullore por që kishin statusin e institucioneve shtetërore. Këto shkolla, ishin nën ingerencën e Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Jugosllave.

2.2. Zhvillimi i arsimit sipas qarqeve

Edhe për këtë kapitull do të ndalemi vetëm në 4 pika, pra në përbërjen e qarqeve, rrjetin shkollor, përfshirjen e nxënësve në shkolla dhe kuadrin mësimor. Po ashtu, qasja do të jetë përshkruese dhe literatura bazë për këtë pjesë do të jetë libri *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore*.

2.2.1. Qarku i Mitrovicës

Rrjeti shkollor: Rrjeti shkollor është zhvilluar sipas komunave shkollore. Në këtë periudhë nuk kishte ngelur asnjë fshat pa u përfshirë në ndonjërin nga komuna shkollore. Vendi më i largët prej nga gravitonin nxënësit për në shkollë ishte prej 10-12 km, ndërsa largësia më e vogël sillej 2-4 km. Në vitin shkollor 1939/40 në këtë rreth punonin gjithsej 17 shkolla fillore. Edhe pse ekzistonin lokalet shkollore në mungesë të mësimdhënësve nuk punonin katër shkolla, ndërsa shkolla fillore në Mitrovicë nuk punonte, sepse aty ishte vendosur ushtria.²⁶

²⁴ Abdulla Vokrri, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore*, (Prishtinë: 1990), 303.

²⁵ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në shekullin XX në Kosovë*, (Prishtinë: 2006), 44. (vepër e cituar)

²⁶ Abdulla Vokrri, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore*, (Prishtinë: 1990), 211. (vepër e cituar)

Përfshirja e nxënësve: Në vitin shkollor 1930/31 shkollat e këtij rrethi vijonin gjithsej 2931 nxënës, prej tyre 943 femra. Edhe në këtë periudhë përfshirja e nxënësve ishte e kushtëzuar nga rrjeti shkollor. Prandaj, nga viti në vit vëreheshin shumë pak ndryshime sa i përket rritjes së numrit të nxënësve. Kështu, sipas të dhënave, në vitin 1937/38 vijonin mësimin 2867 nxënës, prej tyre 1152 femra. Vlen të theksohet se në fund të kësaj periudhe disa shkolla ishin shndërruar në kazerma ushtrie.

Kuadri arsimor: Sipas të dhënave të kohës marrë nga studiuesi Abdulla Vokri, në vitin 1930/31 punonin gjithsej 56 mësimdhënës, prej tyre 33 femra. Ndërkohë, në vitin 1937/38 në të gjitha shkollat e këtij rrethi jepnin mësim 49 mësimdhënës, prej të cilave 16 femra. Vlen të theksohet se kemi rënie të mësuesve në këtë periudhë.

2.2.1. Qarku i Pejës

Përbërja: Sipas ndarjes territoriale të vitit 1931, rrethi i Pejës bënte pjesë në Banovinën e Zetës, me qendër në Pejë. Ky rreth përbehej prej këtyre komunave administrative: komuna e Beranit, Budisallcit, Gorzhenavcit, Novosellës, Gllavicicës, Pejës, Rugovës dhe ajo e Strelcit. Kishte 44 488 banorë. Rrethi i Istogut përbehej nga këto komuna: Vrella, Gjurakovci, Zllakuqani, Istogu dhe ajo e Rakoshit. Ky rreth në vitin 1931 kishte 25918 banorë, qendra e tij ishte Istogu.²⁷

Rrjeti shkollor: Në vitin shkollor 1931/32 rrethi i Pejës dhe i Istogut së bashku kishin 25 shkolla fillore. Prej tyre 21 ishin në pronësi të këshillit të shkollave, ndërsa katra ishin në pronësi private. Kurse, duke filluar që nga viti shkollor 1935/36 e deri në vitin shkollor 1940/41, në këto rrethe vërehet një stagnim i dukshëm në zgjerimin e rrjetit shkollor.²⁸

Përfshirja e nxënësve: Si në çdo qark edhe në këtë varej shumë përfshirja e nxënësve me zhvillimin e rrjetit shkollor. Prandaj, sipas të dhënave, në vitin 1931/32 kishte 3975 nxënës, prej të cilave 888 femra. Ndërkohë, më vonë, sidomos gjatë viteve 37-41, kishte një rënie të numrit të nxënësve edhe për shkak të rënies së numrit të mësimdhënësve. Këta të fundit kishin filluar inkudrimin në lëvizje komuniste.

²⁷ Abdulla Vokri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 216. (veper e cituar)

²⁸ Abdulla Vokri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 216.

Kuadri mësimor: Në vitin 1930/31 në të gjithë shkollat e këtyre rretheve kishte 85 mësimdhënës, prej të cilëve 10 femra. Në vitin shkollor 1936/37 në të gjithë shkollat e këtyre rretheve jepnin mësim më se 108 mësimdhënës, prej të cilëve 31 femra. Krahasuar me vitet e kaluara vërehet një shtim i vogël i kuadrit mësimor.²⁹

2.2.2. Qarku i Gjakovës

Përbërja: Në kohën Mbretërinë Jugosllave rrethi i Gjakovës bënte pjesë në Banovinën e Zetës. Në kuadër të këtij rrethi bënin pjesë këto komuna administrative: komuna e Gjakovës, Gërmnajanit, Rogovës, Deçanit, Junikut, Ponoshevcit, Brovinës, Rrëzniqit dhe Janoshit³⁰.

Rrjeti shkollor: Sipas dokumenteve të kohës e të gjetura në librin e Abdulla Vokrrit në këtë rreth në vitin 1930/31 punonin 11 shkolla fillore. Pra del që kemi pasur një rrjet shkollor tejet të varfër. Mirëpo gjatë kësaj hapësire kohore del se numri i shkollave ishte rritur. Kështu në vitin 1940/41 numri i shkollave ishte 23, kurse paralele 69.

Përfshirja e nxënësve: Për shkak të rrjetit të dobët të shkollave numri i përfshirjes së nxënësve ishte i vogël. Saktësisht në vitin 1930/31 në të gjithë shkollat e këtij rrethi vijonin mësimet 750 nxënës prej të cilave 45 femra. Ndërkohë nëpër vite për shkak edhe të shtimit të numrit të komunave shkollore rritet numri, ndërsa pjesëmarrja e femra ishte e vogël dhe sidomos shqetësuese ishte te shqiptarët.

Kuadri mësimor: Shkollat në këtë rajon, sipas Abdulla Vokrrit, asnjëherë nuk kanë qenë sa duhet të kompletuar me mësimdhënës. Në vitin 1934/35 kishte gjithsej 72 mësimdhënës, kurse gjatë viteve të tjera ka pasur lëvizje dhe mungese të madhe.. Në periudhën 1934/35- 1940/41 kemi pasur rënie dhe për plotësim të nevojave duheshin edhe 9 mësimdhënës.

2.2.3. Qarku i Graçanicës

Përfshirja: Që nga viti 1931 e këndej rrethi i Graçanicës bënte pjesë në Banovinën e Vardarit. Në këtë qark bënte pjese edhe rrethi i Nerodimës, ku përfshinte Ferizajin, Shtimen,

²⁹ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 216.

³⁰ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 216

Kosinës, Babushit, Telinovicit, Nerodimës, Gaçkës, Gotovushës dhe Shterpcës. Mirëpo për shkaqe të numrit e përfshirjes, ne do të ndalemi vetëm te pjesa e Graçanicës. *Ky rreth përbehej prej këtyre komunave administrative: Prishtina, Obiliqi, Goleshit, Drenicës, Sedilarit, Lipjanit, Janjevës, Gushtricës, Devet Jugoviqit dhe të Llukarit*³¹.

Rrjeti shkollor: Në këtë qark, në bazë të të dhënave, del se ishte punuar më shumë për ngritjen e ndërtimin e shkollave. Por meqenëse si rajon ishte i madh, prapë shkollat e ndërtuara nuk plotësonin të gjithë kapacitetin e duhur, andaj shumë nxënës kanë mbetur jashtë.

Kuadri mësimor: Në këtë qark në vitin 1931/32 punonin gjithsej 94 mësime, prej tyre 50 femra. Duke filluar që nga viti shkollor 193/36 e deri në vitin shkollor 1940/41 nuk vëreheshin ndryshime të mëdha, Për plotësimin e nevojave shkollore në vitin shkollor 1940/41 nevojiteshin edhe 19 arsimtarë. Proporcionalisht në çdo mësime vinin nga 18 nxënës³².

2.2.4. Qarku i Gjilanit

Përfshirja: Në periudhën e Mbretërisë Jugosllave rrethi i Gjilanit bënte pjesë në Banovinën e Vardarit. Komunitet të cilat e përbenin këtë banovinë janë: Gjilani, Vitia, Vaganeshi, Vërboci, Kolloleqi, Kamenica, Bostani, Hajnovci, Hogoshti, Parallova, Pozharani, Sllatina, Ranillugi, Rogocica, Pasjani, Parteshi dhe ajo e Shurdhanit me qendër në Zhegër.

Rrjeti shkollor: Këtë pjesë do ta sjell në formë tabelare.

³¹ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 227.

³² Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 227.

	Nr i shkollave	Nr. i paraleleve
1929/30	33	62
1930/31	33	60
1931/32	33	56
1932/33	34	63
1933/34	35	64
1934/35	35	68
1935/36	35	71
1936/37	36	70
Tabela 6		

Përfshirja e nxënësve:

	Numri i nxënësve		
	meshkuj	femra	gjithsej
1929/30			
1930/31	1762	860	2622
1931/32	2092	686	2778
1932/33	1873	566	2438
1933/34	2352	725	3077
1934/35	1510	777	2287
1935/36	2615	885	3500
1936/37	2695	911	3605
Tabela 7			3789

Kuadri mësimor: Në këtë rreth numri i mësimdhënësve ishte i varfër, kështu në vitin 1936/37 punonin gjithsej 71 mësimdhënës, prej të cilëve më se 40% femra. Proporcionalisht në çdo mësues vinin nga 2 nxënës, çka ishte jashtë çdo norme pedagogjike. Nisur nga numri i

përgjithshëm i mësuesve të këtij rrethi dhe nga rrethanat në të cilat kanë punuar ata, ka qenë e pamundur që të arrihet diç ë tepër në ngritjen e nivelit arsimor të këtij mjedisi³³.

2.2.5. Rrethi i Drenicës

Përfshirja: Nëperiudhën e Mbretërisë Jugosllave rrethi i Drenicës me qeder në Serbicë së bashku me rrethin e Llapit me qendër në Podujeve dhe me atë të Vuçitërnës me qendër në Vuçiternë i takonin të njëjtës qendër të inspektimit të arsimit, qendra e së cilit ishte në Vuçiternë³⁴.

Rrjeti shkollor: Në periudhën e vitit shkollor 1930/31 dhe deri në vitin 1937/38, sipas të dhënave të kohës, në këtë rreth janë hapur gjithsej 14 shkolla fillore e 124 paralele, Kjo pasqyrë e shkollave tregon për varfërinë e këtij rrjeti në këtë rreth.

Përfshirja e nxënësve: Përfshirja e nxënësve shqiptarë ishte simbolike edhe në këtë rreth. Ndërkohë pjesëmarrja në nivel të përgjithshëm ishte e vogël për shkak të rrjetit të dobët të shkollave. Në vitin 1930/31 në të gjithë shkollat e këtij rrethi kishte 956 nxënës, prej të cilëve 86 ishin femra.

Kuadri mësimor: Kishte mungesë të madhe të mësimdhënësve në këtë rreth, , saqë në mungesë të tyre në vitin 1934/35 nuk punonin tri shkolla të cilët kishin 4 paralele nxënësish. Mesatarisht te një mësues vinin 78 nxënës. Ndërkohë për të plotësuar nevojat duheshin edhe 7 mësues. Kurse sa i përket kualifikimit të mësuesve, ky rreth qëndronte më mirë. Vetëm 4 nga totali i mësimdhënësve nuk ishin përkatës.

2.2.6. Rrethi i Llapit

Rrjeti shkollor: Ky rreth kishte rrjetin më të pazhvilluar në tërë Kosovën, sepse, siç dihej, kolonializimi kishte filluar më vonë. Dhe, si rezultat, as pa ndryshimeve, nuk ishte bërë zgjerimi i rrjetit me një intesitet të madh. Për shembull në vitin 1938/39 në këtë rreth punonin këto shkolla:

³³ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, (Prishtinë: 1990), 234. (veper e cituar)

³⁴ Abdulla Vokrri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 234.

shkolla fillore në Podujeve, Sibovc, Dumnicë, Lupq, Bajcinë, Majac, Turuqice, Halabak, Pollatë, Prapashticë, Veliko Rekë, Orllan, Koliq, Svegël, Kërpimeh dhe në Herticë³⁵.

Përfshirja e nxënësve: Në vitin shkollor 1930/31 në të gjitha shkollat e këtij rrethi mësimet i vijonin 856 nxënës, prej të cilëve 48 ishin femra. Largësia më e madhe prej nga gravitonin nxënësit ishte 4-6 km. Edhe në këtë rreth pjesëmarrja e shqiptareve ishte e vogël, kurse pjesëmarrja e vajzave edhe më e vogël.

Kuadri mësimor: Duke shikuar përbërjen kualifikuese të mësimdhënësve të këtij rrethi si dhe rrethanat në të cilat vepronin ata, sukseset e arritura në shkollë ishin të përgjysmuara. Në vitin shkollor 1930/31 në rrethin e Llapit punonin gjithsej 12 shkolla fillore, në të cilat jepnin mësim 22 mësimdhënës. Prej këtyre vetëm 8 kishin kualifikimet përkatëse, të gjithë të tjerët ishin të pakualifikuar. Në mesin e tyre kishte oficerë ushtarakë, teologë, gjimnazistë e të tjerë³⁶.

2.3. Përmbledhje

Kjo periudhë kohore për arsimin kishte po të njëjtat probleme me periudhën paraprake. Kuadri mësimor e zhvillimi i rrjetit shkollor nuk ishte në nivelin e duhur, kurse përfshirja e nxënësve linte për të dëshiruar. Po si periudha 1918-1929, ashtu edhe kjo periudhë për shqiptarët ishte e errët. Këto vinin në përgjithësi për shkak të rrethanave ekonomike e politike për tërë Ballkanin, kurse në veçanti për shqiptarët edhe për shkak se nuk u njihej asnjë e drejtë elementare e qenies së tyre si shqiptar. Ndonëse shkollat hapeshin, ato prapë përjashtonin mundësinë e përfshirjes më të madhe për shqiptarët. Kjo vinte edhe si rrjedhojë se këto shkolla hapeshin në vende me ku jetonin serbë dhe i gjithë mësimi zhvillohej në gjuhën serbe. Si pikënisje ishte disavantazh për shqiptarët dhe kjo forconte idenë e pamundësisë së përfshirjes së tyre në këtë proces arsimor. Madje edhe ata që përfshiheshin ishin të diskriminuar, sepse në bazë të plan-programeve synohej sa më shumë asimilimi e marginalizimi i substancës etnike shqiptare.

³⁵ Abdulla Vokrri, "Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore", 244. (veper e cituar)

³⁶ Abdulla Vokrri, "Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore", 244. (veper e cituar)

Element tjetër i theksueshëm në këtë periudhë ishte edhe mungesa e shkollimit të vajzat. Sidomos kjo vërehej të shqiptarët, ndërsa kuadri mësimor ishte joshqiptarë, përjashto rastet të kleri fetarë.

3. Vështrim empirik

Përmbajtja e punimit materie mësimore për klasën e pestë te SHFMU-të. Teksti mësimor “Historia 5”, nga autorët: F. Rexhepi & F. Demaj, i ribotuar në vitin 2020, është me volum prej 112 faqesh, i përgatitur për nxënës të klasës së pestë. Përmbajtja mësimore e tekstit është e ndarë në gjashtë tema (kapituj). Ky tekst është i hartuar sipas plan-programit mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës e Kosovës. Ndërkohë, plan-programi është i vjetër dhe ndryshimi i tij është në pilot-porjekt. Pritet që nga vitit shkollor 2021/22 të obligohet implementimi i plan-programit të ri, ku më pastaj të hartohet edhe teksti shkollor i ri.

Përmbajtja:

1. **Kapitulli i parë** - fillon rreth sqarimit të nocioneve historike dhe shtjellon historinë dhe kulturën ilire.
2. **Kapitulli i dytë** - është histori e mesjetës, ku njësitë mësimore janë të përqendruara rreth historisë së Arbërisë, domethënë periudhës parakombëtare, jetesës së arbërve, pushtimin osman e deri te Beteja e Kosovës.
3. **Kapitulli i tretë** - është histori kryesisht e kohës së pushtuar nga perandoria osmane dhe qëndresa e popullit shqiptar, beteja të ndryshme, histori për Skënderbeun, pastaj histori për arsimin e kulturën shqiptare të shek XV - XVII.
4. **Kapitulli i katërt** - është histori e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.
5. **Në kapitullin e pestë** - është pasqyruar histori shqiptare gjatë viteve 1912 - 1945. Në këto njësi mësimore janë theksuar ngjarjet nga Qeveria shqiptare e Ismail Qemalit, dy luftërat botërore dhe historia shqiptare në pjesën e parë të shekullit njëzet.
6. **Në kapitullin e gjashtë** - të teksti i historisë së klasës së pestë pasqyrohet historia shqiptare pas luftës së dytë botërore. Përpjekjet e shqiptarëve të mbetur nën Jugosllavi, ngritjet kulturore dhe arsimore të shqiptarëve dhe kryesisht të kosovarëve, lufta për çlirim nga okupatori serb e deri të shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Koment: Në bazë të plan-programit lëndor të Kurrikulës së Kosovës, objekti i studimit tonë përfshihet sipërfaqësisht në kapitullin 5 të këtij libri, saktësisht vetëm përmes një njësie mësimore

e cila ndodhet 80-81. Kjo përfshirje është bërë në bazë të kërkesë së plan-programit. Titulli i njësisë mësimore është **Kosova ripushtohet nga Serbia** dhe përfshin në vija të përgjithshme këtë periudhë. Pra, meqenëse kjo periudhë ka specifikat e veta, çështja e gjendjes së arsimit nuk është paraqitur si duhet e sa duhet. Prandaj ne mëtojmë se në plan-programin e ri, do të ishte e rrugës që të ketë një rezultat të veçantë për gjendjen e arsimit në këtë periudhë.

Diskutime dhe konkluzione

Ky punim pasqyron në mënyrë modeste nga historinë e arsimit në Kosovë në periudhën 1918/1941. Rrethanat politike e shoqërore, si dhe ato ekonomike. Kurse, sa u përket vështirësive, ne jemi munduar të sjellim një pasqyrë reale përmes kapitujve të shtjelluar. Si fillim trajtohet në mënyrë të përgjithshme kjo periudhë për arsimin në përgjithësi, e për shqiptarët në raport me arsimin nëveçanti. Jemi munduar të jemi të kujdesshëm në sjelljen e tabelave që tregojnë faktet e kohës dhe të paraqesim mendimet e studiuesve për këtë kohë. Së dyti, sjellim kapitull të veçantë për periudhën 1918-1929, ku arsimit në përgjithësi kishte vështirësitë e veta dhe në veçanti për shqiptarët dhe gjendja e tyre në këtë periudhë. Del se pjesëmarrja ishte e vogël, kuadri profesional shumë i vogël për të gjithë dhe infrastruktura shumë e varfër, por sidomos për shqiptarët ishte në gjendjen të mjerueshme. Ky mjerim pjesëmarrës vinte edhe si rezultat i politikave shtetërore që vinin nga lart, ku shqiptarëve u ndalohej arsimit në gjuhën shqipe e diskriminimi për asimilim ishte politikë e përgjithshme e orkestruar përmes dokumenteve e literaturës. Se treti, sipas kritereve të njëjta, kemi pasqyruar edhe periudhën 1929/1941, ku ngjashëm si në periudhën paraprake del se arsimit në Kosovë nuk kishte ndonjë progres të theksueshëm, aq më shumë për shqiptarët. Prapë mësimi organizohej vetëm në gjuhën serbe e shqiptarët ishin para dy zgjedhjeve aspak të mira, ose të ndiqnin mësimin në gjuhën serbe, ose ta bojkotonin atë. Se këndejmi, as kuadri mësimor nuk ishte i mjaftueshëm, as rrjeti shkollor i pasur. Madje rrjeti shkollor ishte i destinuar vetëm në vende ku jetonin serbë. Dhe, në fund, kemi ofruar në vështrim empirik nga libri Histori 5, libër që mësohet në të gjitha shkollat e Kosovës. Trajtimi i kësaj teme është minimal e në vija të përgjithshme.

Rekomandime

Pavarësisht rrethanave të vështira në këtë periudhë për arsimin në Kosovë e, sidomos, për shqiptarët, unë si mësimdhënëse do të mundohem që ta vë në pah përpjekjen e popullit shqiptar për përndritje dhe ta përdori këtë diskriminim të asaj kohë si ndërgjegjësim për brezat e rinj për kultivimin e dashurinë më të madhe për arsim. Të gjithë pushtuesit janë munduar që përmes gjuhës, kulturës e arsimit të na asimilojmë, siç shihet edhe në këtë periudhë, por ne si popull gjithnjë kemi arritur ta ruajmë substancën tone kombëtare mbi parime universale siç janë gjuha, kultura e arsimit.

Le ta zbardhim të kaluarën tonë si vetëdije e përndritje për të ardhmen, ndërsa le të punojmë për të tashmen tonë që e ardhmja mos të jetë si e kaluara jonë!

LITERATURA

1. Demaj, Frashër, & Rexhepi, Fehmi, Histori 5, Libri Shkollor, (Prishtinë: 2020).
2. Grup autorësh, Kosova dikur e sot, (Prishtinë:1972).
3. Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar III, (Tiranë: 2007).
4. Gjoshi, Ragip, Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë, (Prishtinë: 2010).
5. Hadri, Ali, Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, (Prishtinë: 2003).
6. Koliqi, Hajrullah, Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar, (Prishtinë: 2012).
7. Petranovic, Branko, Istorija Jugoslavije 1918-1978, (Beograd: 1990).
8. Rexhepagiq, Jashar, Skolstvo I prosveta na Kosovo od kraja XVIII stoleca do 1918 godine, (Prishtinë:1974).
9. Rushiti, Liman, Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928, (Prishtinë: 1981).
10. Shatri, Bajram, Arsimi dhe shkollat e mesme në shekullin XX, (Prishtinë: 2010).
11. Shatri, Bajram, Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX, (Prishtinë: 2006).
12. Vokri, Abdullah, Shkolla dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, Prishtinë,
13. Jovanovik, Maria, Prosvetno politickite prilike, vo vardarska Makedonija 1918-1929, (Skopje: 1983).